

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	624-26-3007-5-2-1
Nr i brendshëm	624-26-18-521

Sa i përket tenderit për Titulli: **Ndertimi i rruges lokale Qamil Kadolli ne Bukosh**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GOE BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Sylejman Vuqeterna Nr03, LI-2, K/O

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049562252

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Lendrit Kokollari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bvl-ko@outlook.com *(Adresa elektronike)*

03.07.2026

(Data e parashtrimt të ankesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim për Kontrat, 05.05.2026

B12 Proces verbali i hapjes së Tenderëve 26.05.2026

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues, 18.06.2026

Vendimi të kërkesës për rishqyrtim:24.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni Kerkesat për rishqyrtim te vendimit te AK

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amendamentuar.

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës;

- **Neni 1 i LPP-së – Qëllimi**

Mendojmë që Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 1 të LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore, për shkak që n akeni eliminuar per kunder faktit qe ne I kemi permbush kerkesat e percaktuara ne DT dhe duke mos zbatuar procedurat që duhet të ndiqën për të zbatuar qëllimin e LPP-së.

- **Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;**

Pretendojmë Autoriteti Kontratues Ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të nenit 7 të LPP-së për shkak qe keni rekomanduar nje operator ekonomik me ofetë me të lart se oferta jone per kunder faktit qe ne I kemi permbush kriteret e percaktuara ne D.T. gjithashu na keni diskriminuar duke na eleminuar duke mos zbatuar procedurat që duhet të ndiqën për të zbatuar LPP-së.

- **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave**

Pretendojmë se ju si Autoriteti Kontratues keni bërë shkelje të dispozitave të nenit 56 të LPP-së , duke mos vlersuar konform kerkesave te percaktura ne dosje te tenderit.

- **Neni 59 i LPP-së- Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

Pretendojmë se Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së për shkak që ekzaminimi dhe vlersimi i tenderit është bërë në mënyr të njëanshëm.(Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues)

- **Neni 60 i LPP-së- Kriteret për Dhënien e Kontratës**

Mendojmë që Autoriteti Kontratues ka bërë shkelje nenit 60 pikes 1.1 të LPP-së duke mos respektuar procedurat ligjore, për shkak që keni REKOMANDUAR nje operator ekonomik i cili ka ofert me te lartë se oferta jon, ne kundershtim me kriteret e percaktuar vet në D.T njëherit duke e demtuar bugjetin ekomunes.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi nr 1

Autoriteti Kontraktues (AK) ka bërë shkelje të dispozitave ligjore duke rekomanduar për kontratë një operator ekonomik që ka paraqitur ofertë me çmim më të lartë se oferta jonë, duke mos zbatuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores së Prokurimit Publik (RRPP), përkundër faktit se ne, si Grup i Operatorëve Ekonomikë (GOE), kemi ofruar çmimin më të ulët dhe njëkohësisht i plotësojmë të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Ne si GOE kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme dhe të qarta për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të dosjes së tenderit. Megjithatë, komisioni i vlerësimit dhe zyrtari i prokurimit nuk kanë vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së, konkretisht me Nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, si dhe me dispozitat e RRPP-së, përkatësisht Nenin 38 – Sqarimi i Tenderëve dhe Nenin 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 40.8.

Në dokumentacionin e tenderit kemi paraqitur dëshmi për secilën pajisje të kërkuar, duke përfshirë:

- Faturat e shitblerjes;
- Transaksionet bankare që vërtetojnë pagesën;
- Fotografi të pajisjeve ku identifikohet qartë prodhuesi dhe modeli i tyre.

Përkundër këtyre dëshmive, zyrtarët përgjegjës nuk i kanë marrë ato parasysh, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së.

Me qëllim të sqarimit të plotë të çështjes, po i ridorëzojmë edhe një herë dëshmitë relevante, përkatësisht faturat e shitblerjes, transaksionet bankare dhe fotografitë e pajisjeve, të cilat vërtetojnë se pajisjet e ofruara nga ana jonë janë plotësisht në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit.

KERKESA E DT:

Kërkesa 3 - Paisjet e nevojshme per kryerjen e ketij aktiviteti OE duhet te ketë

Nje (1) Grejder me peshë min 12 Ton.

Deshmia e kerkuar:

Dëshmia 3 - Dëshmi mbi posedimin e paisjeve, nëse pajisjet janë në pronësi të OE duhet të ofroj Librezat kopje (paisjet duhet të jenë me afat të regjistrimit), ndërsa për paisjet që nuk kanë Libreza (Dokumentin Unik Doganor (DUD), faturë shtiblerje të dëshmuar nga banka). Nëse OE nuk i ka pajisjet në pronësi duhet të ofrohen marrëveshjet për shfrytëzim të paisjeve për këtë projekt (nuk pranohen marrëveshjet e përgjithshme) dhe dëshmitë mbi paisjet (Librezat kopje, DUD, fature shitblerje me dëshmi bankare). AK ruan të drejtën e vizitës në teren për verifikim të pajisjeve.

Ne GOE kemi ofruar deshmi per marrveshje duke ja bashkangjitur Faturen e Shit blerjes dhe Transaksionin Bankar.

Bashkangjitur i keni ne ANKESË si dëshmi.

NP"EURO BAG"
70572516
PRISHTINE

NNT"BURIMI"
MALISHEVE
80140207

FATURA : 6/09

Date: 07.12.2009

Nr. Pershkrimi i mallit	Njesia	Sasia	cmimi	Vl.totale
1.Greder F156A 1988	Cope	1	23.300,00	23.300,00
			Gjithsej:	23.300,00
			TVSH 16%	3.728,00

Gjithsej: 27.028,00

Bleresi:



Shitesi:





O&K Orenstein & Koppel Aktiengesellschaft

Fahrzeugtyp	F 156, A	Fahrzeug-Ident.-Nr.	3236905
Fabrik-Nr.		zul. Ges. Gew. Kg	15800
Baujahr	1938	zul. Achslast Kg	5200
		vorn	hinten
			11500

710153

MMWR.3623313500

O&K Orenstein & Koppel
Antriebsart
Heizrichtung, Typ H 912-1
Fabr.-Nr. 156
zulässiger Betriebsdruck 9 bar
Nennspannung 24 V
Druckeinheit 5,187

Pretendimi nr 2

Gjithashtu, vlen të theksohet se AK-ja ka kryer edhe shkelje të tjera të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke rekomanduar për dhënie të kontratës një operator ekonomik që nuk ka paraqitur ofertën me çmimin më të ulët.

Kjo për faktin se në ofertën financiare për pozicionin "**Rruga B – Rruga Baki Izlami – Vazhdim, L = 55 m**" ekziston një gabim aritmetik në vlerën prej **605.00 €**, i cili nuk është identifikuar dhe as korrigjuar gjatë procesit të vlerësimit. Si pasojë e këtij gabimi, vlera e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar është më e lartë se ajo e llogaritur nga Komisioni i Vlerësimit, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në renditjen e operatorëve ekonomikë dhe në rekomandimin për dhënie të kontratës.

3 Punët e Betonit					
POS	PËRSHKRIMI I PUNËVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	SHUMA
3.01	Furnizimi, transporti dhe punimi i gurit skajor të ngritur 15/22/80cm prej Betoni me kualitet acc. EN1340:2003, C35/45, klasa e ekspozimit : XD3, XF4, M100 i vendosur në shtresë betoni C16/20 gjithnjë sipas standarteve, duke përfshirë edhe testimet laboratorike për soliditet në shtypje, lakim abrazion dhe ngrirje-shkrirje, si dhe mbushja e fugave me llaq betoni.	m'	55.00	€ 11.00	€ 605.00
3.02	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubzave prej betoni të klasës C-35/45 me trashësi t=80mm për rrugën dhe zgjerimet, në çmim të llogaritet edhe furnizimi dhe shtruarja e rërës me frak. (4-8)mm me trashësi t=3-5cm si dhe mbushja e fugave me rërë, gjithnjë sipas rregulloreve EN 1338 duke përfshirë edhe zgjerimet dhe kyqjet në rrugë. Në pozicion përfshihet edhe ngjeshja me vibroplakë. Përzgjedhja e formës dhe dimensioneve të kubeza, duhet të behet nga investitori (organi mbikqyres).	m ²	220.00	€ 13.00	€ 2,860.00
TOTAL POZICIONI				3	€ 2,860.00

Në vend të vlerës prej **2,860.00 €**, duhej të ishte llogaritur vlera prej **3,465.00 €**, çka paraqet një gabim aritmetik në shumën prej **605.00 €**. Si rrjedhojë e këtij gabimi, vlera totale e ofertës nuk është **33,333.00 €**, por duhej të ishte **33,938.00 €**.

Pavarësisht se ky gabim është i qartë dhe lehtësisht i verifikueshëm, ai është anashkaluar nga Komisioni i Vlerësimit dhe zyrtari i prokurimit. Për pasojë, është ndikuar drejtpërdrejt në renditjen përfundimtare të

operatorëve ekonomikë, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë, transparencës dhe vlerësimit të drejtë të ofertave.

Ky fakt dëshmon se Komisioni i Vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP), siç është argumentuar edhe në pretendimet e mësipërme.

Mosidentifikimi dhe moskorrigjimi i një gabimi të tillë aritmetik ngre dyshime serioze mbi profesionalizmin dhe paanshmërinë e Komisionit të Vlerësimit. Kjo lë të kuptohet se Komisioni ose nuk ka kryer një vlerësim me kujdesin e duhur profesional, ose ka vepruar në mënyrë selektive, duke favorizuar një operator ekonomik në dëm të kompanisë sonë, në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik

Pretendimi nr 3

Duke analizuar ecurinë e ngjarjeve në këtë procedurë, edhe përkundër faktit se ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme që procedura të kthehet në rivlerësim, AK-ja ka vazhduar me shkelje të tjera, duke pretenduar se ne nuk kemi përmbushur kërkesën për kapacitetet profesionale.

Ne pretendojmë se AK-ja, përkatësisht zyrtari i prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, duke u munduar që, me çdo kusht, të na eliminojë nga gara dhe, pa e kthyer lëndën në rivlerësim, ka shtuar pretendime të tjera në vendimin për refuzimin e kërkesës.

Ne e sqarojmë OSHP-në se pretendimi i tyre nuk qëndron dhe se dëshmitë tona për stafin profesional janë në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit (D.T.).

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

- Te aprovohet ne tërësi ANKESA si e bazuar
- ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për aktivitetit të prokuirmtit
- DETYROHET AK- Komuna e Suharekes që të rekomandoi për Nënshkrim të Kontratë GOE: BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK
- Te merren masa ndaj zyrtarve te involvuar ne kete procedur.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

GOE BVL KO (Lendrit Kokollari B.I.); REXHA SHPK, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tij ekonomike dhe ligjore, njofton se, në rast të vazhdimit të veprimeve të kundërligjshme nga Autoriteti Kontraktues, do të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të lejuara sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës. Njëkohësisht, GOE rezervon të drejtën që pranë organeve kompetente të paraqesë kërkesë për kompensimin e dëmit, duke përfshirë edhe fitimin e humbur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*